| **Buletini Nr. 322 / 2025, 17-11-2025** | **Parashikimi** nga 17-11-2025, ora 12:00 deri 18-11-2025, ora 23:59. |
|---|---|

## PARASHIKIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET

---------------------------------------------------

Sot pasdite (e hënë, dt. 17) dhe nesër (e martë, dt. 18) do të ketë reshje me intensitet të lartë në të gjithë vendin. Në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Vlorë dhe Gjirokastër mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane, në këto qarqe mund të shfaqen probleme me përmbytje të lokalizuara, në varësi të gjëndjes së kanalizimeve.
Intesiteti i lartë i reshjet në ditët në vijim do të sjellin rritje të prurjeve në lumenjtë e mëdhenj dhe të mesëm Drin-Buna, Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin dhe Vjosa.

## PARASHIKIMI METEO

**-----------------------**

### RESHJET

Sot pasdite (e hënë, dt. 17) dhe nesër (e martë, dt. 18) priten reshje shumë intensive në qarkun Shkodër ndërsa në qarqet Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Vlorë dhe Gjirokastër priten reshje intensive deri lokalisht shumë intensive. Në qarqet e tjera priten reshje mesatare deri lokalisht intensive. Në të gjithë territorin reshjet do të shoqërohen me shtrëngata (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

### TEMPERATURA

Nesër (e martë, dt. 18) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:
në bregdet: 15 / 20 °C
në vendet e ulëta: 15 / 20 °C
në vendet malore: 9 / 14 °C

### ERA

Sot pasdite (e hënë, dt. 17) dhe nesër (e martë, dt. 18) era pritet të fryjë mesatare deri e fortë kryesisht në bregdet.

| ***NIVELET E RREZIKUT*** | **S'KA RREZIK** | **I ULËT** | **I MODERUAR** | **I LARTË** |
|---|---|---|---|---|

## *PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)*

| ***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT*** | ***Zjarre në pyje*** | ***Ngjarje Meteorologjike*** | | | ***Ngjarje Hidrologjike*** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ***Zjarret Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara*** | ***Shtrëngata*** | ***Përmbytje të Shpejta*** | ***Përmbytje Lumenjsh*** | ***Rrëshqitje toke*** |
| **SHKODËR** | S'KA RREZIK | shumë intensive | | | | | |
| **KUKËS** | S'KA RREZIK | intensive | shumë intensive | | | | |
| **DIBËR** | S'KA RREZIK | intensive | shumë intensive | | | | |
| **LEZHË** | S'KA RREZIK | intensive | shumë intensive | | | | |
| **DURRËS** | S'KA RREZIK | intensive | shumë intensive | | | | |
| **TIRANË** | S'KA RREZIK | intensive | shumë intensive | | | | |
| **ELBASAN** | S'KA RREZIK | mesatare | intensive | | | | |
| **FIER** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **BERAT** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **KORÇË** | S'KA RREZIK | mesatare | intensive | | | | |
| **VLORË** | S'KA RREZIK | intensive | shumë intensive | | | | |
| **GJIROKASTËR** | S'KA RREZIK | intensive | shumë intensive | | | | |

## LEGJENDA: *Reshjet 24-orëshe*

| **Niveli i Rrezikut** | ***Reshje shiu*** (mm / 24 orë) |
|---|---|
| S'KA RREZIK | të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë)<br>Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I ULËT | mesatare (15 – 45 mm / 24 orë)<br>Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I MODERUAR | intensive (45 – 90 mm / 24 orë)<br>Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike. |
| I LARTË | shumë intensive (> 90 mm / 24 orë)<br>Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive. |




***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 17- 18.***

## LEGJENDA: *Zjarre në pyje*

| | |
|---|---|
| S'KA RREZIK | Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht. |
| ULËT | Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara. |
| I MODERUAR | Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme. |
| I LARTË | Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë. |

## *SIMBOLE*

| | |
|---|---|
|  | Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme |
|  | Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël |
|  | Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj |
|  | Rrëshqitje toke |